



Ti dyshohesh për një vepër penale

Si i dyshuar të kanë ndaluar dhe të kanë marrë në komisariat (të policisë) ose në ndonjë vend tjetër për marrje në pyetje. Ose je ftuar për t'u marrë në pyetje. Cilat janë të drejtat e tua?

Ke moshë 12 deri 18 vjeçe dhe dyshohesh për një vepër penale. Policia apo një shërbim tjetër hetimor të ka ndaluar dhe të ka marrë në komisariat që aty të të bëjë pyetje. Kjo quhet marrje në pyetje. Ose je ftuar që të vish në komisariat. Është e rëndësishme që të dish se cilat janë të drejtat dhe detyrimet e tua. Lexoje prandaj me kujdes këtë fletë informuese.

Ke pyetje?

Mos ke pas kësaj ndonjë pyetje? Ato mund t'ia drejtosh avokatit tënd, policisë ose ndonjë shërbimi tjetër hetimor me të cilin do të kesh punë. Aty ku në këtë fletë informuese përdoret termi "polici", mund të nënkuptohet edhe ndonjë shërbim tjetër hetimor.

Vizito për më tepër informacione www.juridischloket.nl ose telefonoji numrit 0900 – 8020 (€ 0,25 për minutë)

Të kanë ndaluar dhe të kanë marrë në komisariat? Njihu me të drejtat e tua

Policia duhet të të tregojë se çfarë ke bërë ti sipas mendimit të tyre.

- Policia ka të drejtë që të bëjë pyetje. Kjo quhet marrje në pyetje (policore).
- Ti nuk e ke të detyrueshme që të përgjigjesh po qe se nuk e do këtë. Ti ke të drejtën e heshtjes;
- Para se të fillojë marrja në pyetje policia angazhon një avokat për

të dhënë këshilla. Mund të zgjasë pak kohë derisa të vijë avokati, zakonisht vjen për dy orë. Biseda me avokatin zgjat maksimumi gjysmë ore. Nëse nevojitet më tepër kohë, kjo bëhet e mundshme. Kjo është pa pagesë. Nëse njeh vetë ndonjë avokat me të cilin do të bisedosh, edhe kjo është e mundshme. Thuaja atëherë këtë policisë.

- Avokati mund të jetë i pranishëm edhe në marrjen në pyetje. Nëse dyshohesh për një vepër të lehtë penale, atëherë ti (apo prindërit e tu) duhet vetë t'i paguash/paguajnë shpenzimet e avokatit. Nëse dyshohesh për një vepër më të rëndë penale (për shembull vjedhje ose ushtrim dhune), atëherë ti nuk paguan asgjë. Pyete avokatin gjatë bisedës së parë se cili nga këto opsione është i zbatueshëm në rastin tënd.
- Po qe se nuk do avokat, në marrjen në pyetje lejohet të jetë i pranishëm një person i besueshëm, për shembull babai yt ose nëna jote. Thuaja atëherë këtë policisë.

Po qe se për angazhimin e një avokati policia ia përcjell të dhënat e tua personale Këshillit për Ndihmë Juridike, të dhënat përpunohen në administratën e Këshillit.

- Nëse nuk e flet apo kupton holandishten, ose e flet shumë pak, atëherë ke të drejtë që gjatë marrjes në pyetje (policore) të asistohesh nga një përkthyes. Po qe se ti nuk e kupton policinë duhet të thuash se nuk kupton. Përkthyesi mundet gjithashtu të ndihmojë nëse do të flasësh me një avokat. Kjo është pa pagesë.
- Në rast se vendoset që të mbetesh në komisariat (të policisë), atëherë policia u telefonon prindërve të tu apo kujdestarit tënd për t'i njoftuar se të mbajnë të mbyllur. Ndonjëherë vendos prokurori që kjo mos të lejohet menjëherë. Atëherë për këtë njoftohet Këshilli për Mbrojtje të Fëmijëve.

- Po qe se vendoset se ti duhet të mbetesh në komisariat (të policisë) dhe nuk ke shtetësi holandeze, atëherë mund të kërkosh nga policia që të njoftojë konsullatën ose ambasadën e vendit tënd të prejardhjes se të mbajnë të mbyllur.
- Nëse je i sëmurë, do të flasësh me një mjek apo të nevojiten ilaçe, këtë duhet t'ia thuash policisë.
- Ti ke të drejtë që t'i lexosh aktet e lëndës, po qe se ekzistojnë të tilla. Prokurori në disa raste mund të vendosë që kjo përkohësisht ende mos të lejohet. Po qe se nuk e kupton holandishten apo e kupton shumë pak, ti ke të drejtë që disa akte apo pjesë të tyre për ty të përkthehen, si për shembull përkthimi i pjesëve më të rëndësishme nga urdhri i paraburgimit tënd dhe fletëthirrjes së gjykatës.

Sa kohë mund të të mbajnë të mbyllur policia?

- Në varësi të veprës për të cilën dyshohesh në komisariat (të policisë) mund të të mbajnë mbyllur maksimumi tri ditë e 18 orë.
- Në rast se është e rëndësishme që të të mbajnë të mbyllur për një kohë më të gjatë, atëherë për këtë duhet të vendosë një gjykatës. Pyet avokatin tënd apo gjykatësin se çfarë mund të bësh po qe se nuk pajtohesh me ndalimin tënd apo se të mbajnë më gjatë mbyllur.

A të kanë ftuar që të vish në komisariat?

Atëherë, para se të merresh në pyetje, ti (ose prindërit e tu) mund të kontaktosh / kontaktojnë me një avokat për t'u këshilluar. Bisedo me atë rast se a do të jetë avokati i pranishëm gjatë marrjes në pyetje apo jo. Ti (ose prindërit e tu) duhet vetë t'i paguash/paguajnë shpenzimet e atij avokati.

Çfarë bën avokati para marrjes në pyetje?

Avokati mbron vetëm interesat e tua. Para marrjes në pyetje, avokati mund t'i bëjë këto gjëra për ty:

- Bisedon me ty për veprën penale për të cilën dyshohesh;
- Të jep këshilla juridike;
- Të tregon se si bëhet marrja në pyetje (nga policia);
- Të tregon se cilat janë të drejtat dhe detyrimet e tua gjatë marrjes në pyetje;
- Kontakton me familjen apo punëdhënësin tënd që t'i informojë për situatën tënde, nëse e dëshiron këtë.

Ato që ti ia thua policisë gjatë marrjes në pyetje janë të rëndësishme sepse shënohen në një raport. Ky raport quhet procesverbal. A i përcillet çështja jote prokurorit apo eventualisht gjyqtarit? Në atë rast ata shikojnë se çfarë është shkruar në procesverbal. Prandaj procesverbalin e marrjes tënde në pyetje duhet ta lexosh mirë. Po qe se je dakord me atë, policia kërkon që të shkruash emrin tënd apo firmën tënde nën procesverbal. Po qe se nuk je dakord me të, kërko që policia atë ta përshtatë. Po qe se në marrjen tënde në pyetje është i pranishëm një avokat, ai apo ajo mund të shikojë për ty se a e ka pasqyruar policia mirë marrjen tënde në pyetje.

Policia nuk dëgjon kur ti bisedon me avokatin. Pa pëlqimin tënd avokati nuk ka të drejtë të bisedojë me të tjerë për ato që ti ia ke treguar atij. As me policinë. E njëjta gjë vlen edhe për përkthyesin, nëse ai të ka asistuar gjatë bisedës me avokatin.

Çfarë bën avokati gjatë marrjes në pyetje?

Avokati rri ulur pranë teje në dhomën për marrje në pyetje dhe ka të lejuar që:

- në fillim dhe në fund të marrjes në pyetje të bëjë vërejtje;
- t'i bëjë pyetje personit që bën marrjen në pyetje;
- të të pyesë ty se a e kupton se çfarë thuhet;
- t'i bëjë me dije policisë nëse ti pyetjet nuk i kupton;
- të kujdeset që ti mos të detyrohesh të thuash diçka;
- gjatë marrjes në pyetje të kërkojë që marrja në pyetje të ndërpritet për t'u këshilluar me ty. Edhe ti mund të kërkosh një ndërprerje. Po qe se ti kërkon shpesh ndërprerje, kërkesa jote mund të refuzohet.

Po qe se e ndien veten tepër të sëmurë që të merresh në pyetje, këtë duhet ta thuash. Atëherë avokati ia thotë këtë policisë.

Ki kujdes: Nëse fillimisht je shprehur se nuk dëshiron avokat gjatë marrjes në pyetje, por megjithatë dëshiron, thuaje këtë. Atëherë prapëseprapë do të jepet kjo mundësi.

Nëse je shprehur se nuk dëshiron avokat gjatë marrjes në pyetje, prindërit e tu ose kujdestari yt mund të vendosin që në marrjen në pyetje megjithatë të jetë i pranishëm një avokat.

Nëse në marrjen në pyetje nuk është i pranishëm një avokat, por një person i besueshëm

Një personi të besueshëm i lejohet vetëm të dëgjojë. Ai/ajo vjen dhe ulet afër teje kur të marrin në pyetje, por nuk ka të drejtë të flasë. Personi i besueshëm duhet të ketë moshën 18 vjeç e më lart dhe nuk duhet të ketë asnjë lidhje me veprën penale për të cilën dyshohesh ti. Personi i besueshëm mund të jetë babai yt ose nëna jote, por edhe ndonjë tjetër person i rritur.



Ky është një botim nga:
Ministria e Sigurisë dhe Drejtësisë
Postbus 20301 | 2500 EH | Den Haag

Mars 2017 | 101106

Në sajë të kësaj flete informuese nuk mund të rrjedhë asnjë e drejtë.